

## Kategoria Superiore/ Vllaznia – Tirana 2-0

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 18 Shtator 2013 15:26

---



Vllaznia ka fituar ndaj Tiranës me mjaft lehtësi në javën e tretë. Dy gola në pjesën e parë dhe asnjë rrezik nga bardheblutë që kanë luajtur për 83 minuta me 10 lojtarë. Një gol i Shtubines dhe një tjetër nga kroati Bushic i kanë dhënë kuqeblutë fitoren e dytë rradhazi. Pasi mundën Kukësin në transfertë, ja dalin edhe me Tiranën në shtëpi dhe pas javës së tretë Vllaznia ka arritur në kuotën e 6 pikeve. E gjithë ndeshja është përcaktuar në pjesën e parë. Kroati Gerc la bardheblutë me 10 lojtarë pas një xhesti antisportiv dhe fale superioritetit numerik kuqeblutë shënuan dy gola të shpejtë dhe moren tre pikët që i duheshin nga ky takim.